



SHOQATA E PRODHUESVE
TË QUMSHITIT TË KOSOVËS
KOSOVO ASSOCIATION OF
MILK PRODUCERS KAMP



Kingdom of the Netherlands

"Commissioned by the Netherlands Enterprise
Agency and funded by the Ministry of Foreign Affairs"

MENAXHIMI I VIÇAVE



Table of Contents

KAPITULLI 1	3
1.1 Pjellja e lopës	3
1.2 Përgatitja.....	3
1.3 Pjelljet e lehta	3
1.4 Ushqimi	3
1.5 Pas lindjes.....	4
1.6 Procedurat standarde të pjelljes.....	4
KAPITULLI 2	4
2.1 RRITJA E VIÇAVE	4
2.2 Kulloshtra	4
2.3 Të ushqyerit me kulloshtër	5
2.4 Kualiteti i kulloshtres.....	5
2.5 Pajisjet për kulloshtër	6
2.6 Të ushqyerit pas periudhës së kulloshtres.....	6
2.7 Zëvendësuesit e qumështit (qumështi pluhur).....	6
2.8 Të ushqyerit me qumësht	7
2.9 Zhvillimi i rumenit të biçit me qumësht, koncentrat dhe sanë	8
2.10 Uji	9
2.11 Ndarja nga gjiri.....	9
2.12 Pesha trupore.....	9
KAPITULLI 3	10
3.1 Strehimi i biçave	10
3.2 Mbajtja e biçave ndaras nga lopët	11
3.3 Mbajtja e biçave në bokse individuale	11
3.4 Mbajtja e biçave në bokse të përbashkëta	11
3.5 Mbajtja e biçave për riprodhim.....	11
Kapitulli 4	12
4.1 Monitorimi i rritjes.....	12
4.2 Matja e peshës së gjalle të biçave/mështjerrave.....	12
4.3 Matja e lartësisë.....	12
4.4 Inseminimi.....	13

KAPITULLI 1

1.1 Pjellja e lopës

Në periudhën 40 ditë para pjelljes dhe 60 ditë pas pjelljes lopët janë shumë të ndjeshme. Gjatë kësaj periudhe, lopa do një kujdes të veçantë sepse kalon nëpër shumë ndryshime që mund të kenë efekt negativ në shëndetin e saj, në pjellshmërinë dhe në prodhim. Streset të cilat mund të ndodhin në këtë kohë nuk duhet nënvlerësuar.

Kur lopët i kalojnë këto 100 ditë pa asnjë problem, ajo do të jep më shumë qumësht gjatë laktacionit, do të ketë më pak probleme për vetën dhe për fermerin. Fokusi kryesor i kësaj broshure do të jetë menaxhimi i vëçave nga lindja deri në mbarsim.

1.2 Përgatitja

Për të parandaluar stresin te lopët sa më shumë që është e mundur, lopët në pjellje nuk duhet të ndahen nga kopeja gjatë kohës së pjelljes. Është mirë që boksi për pjellje të jetë sa më i madh, të ketë shtrojë të terur me kashtë apo material tjetër të butë dhe lopa gjatë pjelljes të ketë kontakt vizual me lopët tjera.

Lopët janë shumë të ndjeshme ndaj infeksioneve gjatë procesit të pjelljes sepse hapja e cervikut mund të ketë plagë të vogla në kanalën e lindjes. Sigurohu që janë ndërmarrë të gjitha masat për të pasur një proces të pjelljes sa më higjienik.



1.3 Pjelljet e lehta

Pjelljet e rënda apo vëçat e mëdhenj kanë ndikim negativ në shëndetin e lopës dhe i marrin kohë me shumë lopës për të rimarr vetën. Pjelljet rënda apo vëçat e mëdhenj shkaktojnë pjellje të vështira, me shumë stres, dhimbje, rrezik me të madh për infeksione dhe probleme tjera si që është mbetja e placentës. Vëçat e mëdhenj mund të jenë si shkak gjenetikës së lopës dhe demit, jo balancimit të racioneve gjatë periudhës së tharjes apo kombinim i të dyjave.

Viçi rritet shumë shpejt gjatë dy javëve të fundit të mbarsmërisë. Ushqimi me shumë proteina dhe energji në fund të mbarsmërisë mund të rritë rrezikun që vëçat të jenë shumë të mëdhenj. Duhet të kemi parasysh që 95% e pjelljeve në fermë duhet të behën pa i ndihmuar fermeri. Ndihma duhet të bëhet vetëm në ato raste kur vëçat janë shumë të mëdhenj apo kur viçi nuk është në pozitën e duhur për pjellje.

1.4 Ushqimi

- Mënjano ushqimet e tepërta gjatë periudhës së tharjes, veçanërisht gjatë 5 javëve të para. Ushqej me silazh apo sanë me strukturë të mirë të fibrave.
- 3 javët e fundit të periudhës së tharjes, ushqej lopët me silazh misri dhe një sasi të vogël të koncentratit mund të ju shtohet. Këtë racion duhet të mbahet edhe 3 javë pas pjelljes.

1.5 Pas lindjes

Pas lindjes se viçit, duhet të sigurohem që viçi është duke marrë frymë lirshëm. Kontrolllo rrahjen e zemrës në mënyrë të rregullt dhe kontrolllo frymëmarrjen a e ka konstante. Kur viçi nuk ka ndonjë reagim, koka e viçit duhet të laget me ujë në mënyrë që viçi të aktivizohet.

1.6 Procedurat standarde të pjelljes

- Sigurimi i hapësirës së mjaftueshme dhe higjienike për pjellje me shtroje të terur me kashtë
- Përdoreni hapësira të veçanta për pjellje, kur lopët janë të sëmura për të parandaluar infeksionet tek lopët dhe viçat
- Pastro dhe dezinfekto pjesën e pasme të lopës para procesit të pjelljes
- Kurrë mos e kontrolllo lopën brenda pa i pastruar dhe dezinfektuar duart
- Mos e kontrolllo lopën shumë herët. Lejo që se pari të hapet cerviku
- Përdoreni lubrifikant dhe siguroni që i keni hequr thonjtë, unazat dhe stolit
- Përdoreni vetëm pajisjet e pastra gjatë procesit të pjelljes.

Për të larguar mukozën nga mushkëritë, viçat mund të varen lartë me kokë poshtë, si për shembull në ndonjë rrethoj. Largoj këmbët e para anash për të bërë masazh zemrës. Kur viçi është duke marrë frymë vetë, thaje viçin apo lere që lopa që ta thaj vet. Rekomandohet që viçi të largohet nga nëna brenda 24 orëve. Sigurohu që viçi të ketë ambientin e ngrohet gjatë kohës kur është ftoftë. Kur temperaturat janë me të ulëta se 10 °C viçat kanë nevojë për ngrohtësi në mënyrë që viçat të teren pa ndonjë problem. Nëse temperatura e ambientit është e ulet edhe temperatura e trupit tek viçi do të ulet e cila ka efekt negativ në shëndetin e viçit.

KAPITULLI 2

2.1 RRRITJA E VIÇAVE

Ndodh shumë shpesh që gjatë rritjes së viçave mos të kemi kujdesin e duhur. Megjithatë, kohët e fundit shumë fermerë po e kuptojnë që vetëm nëse kemi kujdes të duhur në rritjen e viçave do të kemi lopë të mira qumështore. Ditët e para të viçit janë shumë të rëndësishme në jetën e viçit dhe e cila e përcakton pjesën tjetër të jetës së tij. Ushqimi kryesor në ditën e parë të jetës është kulloshtra.

2.2 Kulloshtra

Kulloshtra është qumështi i parë që lopa e prodhon menjëherë pas pjelljes. Ajo është e trash, me ngjyrë të verdhë e cila është shumë e rëndësishme për shëndetin e viçit. Kulloshtra përmban antitruapat (imnoglobina) e cila kalon muret e zorrëve të viçat pa asnjë problem në 24 orët e para të jetës së tij. Muret e zorrëve fillojnë të mbyllen pas lindjes dhe për këtë arsye sa më shpejt që ti jepet kulloshtra viçit me shumë imnoglobulinë viçi do të absorboj. Këto imnoglobulina janë shumë të nevojshme sepse viçi linden pa ndonjë imunitet. Kulloshtra do të rritë mundësinë që viçi të jetë i shëndetshëm gjatë muajit të parë.

Për tu siguruar se viçi ka marrë sa më shumë antitruapa që është e mundur, rreth 4 litër kulloshtrë duhet ti jepet brenda një ore pas pjelljes. Kualiteti i kulloshtrës është shumë me rëndësi dhe po ashtu kulloshtra duhet ti jepet shpesh për tu siguruar që viçi ka marrë sasinë e mjaftueshme të kulloshtrës. Sasia e imnoglobulinës në kulloshtrë ulet shumë shpejt.

2.3 Të ushqyerit me kulloshtër

Fermerët shpesh herë nuk i ushqejnë me sasi të mjaftueshme me kulloshtër për shkak se frikohen se viçat do të sëmuren nga diarreja. Diarreja nuk është arsye për të ulur sasinë e kulloshtres. Sasia e mjaftueshme e kulloshtres do të holloj jashtëqitjet e viçit. Kur viçat kanë jashtëqitje të trash atëherë është shenj që viçi ka marr sasi të vogël të kulloshtres.



Gjatë 24 orëve të para pas lindjes viçat duhet të pinë kulloshtër 20 % të peshës trupore. Gjatë ditës së dytë rreth 10 % të peshës trupore do të jetë e mjaftueshme me kulloshtër. Se paku dy ditë duhet të ushqehet me kulloshtër para se të kaloj me qumësht apo zëvendësim të qumështit.

Si të llogarisim sasinë e kulloshtres në bazë të peshës trupor të viçit?

Llogaritja:

Një viç normal i racës Hollshtain peshon prej 20-50 kg. Kjo do të thotë që mesatarja e një viçi do të jetë 35 kg, i cili duhet të ushqehet me 7 kg kulloshtër në ditën e par ($0.20 \times 35 = 7$ kg kulloshtër në ditën e par).

Një viç i rasës Simental mund të peshoj prej 30-55 kg. Kjo nënkupton se mesatarja e viçit është 45kg dhe i cili duhet të ushqehet 9 kg kulloshtër në ditën e par ($0.20 \times 45 = 9$ kg kulloshtër në ditën e par).

Pra siç u pa nga këta dy shembuj sasia e kulloshtres varet nga pesha e viçit në lindje, sa më i madh të jetë viçi, sasia e kulloshtres duhet të jetë më e madhe.

2.4 Kualiteti i kulloshtres

Është më mirë që viçat të ushqehen me kulloshtren e nënës së vet. Sidoqoftë kjo gjithmonë nuk është e mundur. Kur nëna jep pak kulloshtër apo të kualitetit të dobët, fermeri mund të përdorë kulloshtër prej lopëve tjera. Zëvendësuesit e kulloshtres po ashtu janë opsione por me shumë rekomandohet kulloshtera natyrale. Kulloshtera e kualitetit të larët mund të ngrihet në frigorifer në racione dhe në paketime të plastikes varësisht nga madhësia e fermës. Sasia e prodhimit të kulloshtres në ditën e par mund të jetë prej 1 – 18 litër. Kualiteti i kulloshtres është më i mirë kur lopët prodhojnë rreth 8 litër kulloshtër. Kur prodhojnë me shumë atëherë sasia e imonoglobulinës është më e vogël.



Shkrirja e kulloshtës

Kur kulloshtira shkrihet për ushqimin e viçave, duhet të sigurohemi që kulloshtira të mos nxehet shumë shpejt sepse mund të shkatërrojë një numër të madh të imonoglobulinave. Në një banjë të vakut është me e përshtatshme për ta shkrirë kulloshtirën. Kulloshtira kur ti jepet viçit duhet të ketë temperaturën 37 °C sa është temperatura trupore e viçit.

2.5 Pajisjet për kulloshtër

Për të qenë të sigurt që viçat po marrin kulloshtër me numër të vogël të patogjenëve, kulloshtira duhet të pasterizohet. Pasterizimi do të shkatërroj bakteret E.Koli dhe bakteret tjera që shkaktojnë sëmundjet të viçat. Po ashtu preferohet që edhe qumështi të pasterizohet i cili përdoret për të ushqyerit e viçave pas kulloshtirës.

Për të përcaktuar se kulloshtira e lopës është e sigurt duhet të përdorim matësin e kulloshtirës. Kur matësi tregon ngjyrën e gjelbër, kulloshtira ka koncentrim prej 60-140 gram imonoglobulin për një kg qumështi.



Klasifikimi	Imonoglobulina/kg kulloshtër (g)
Shumë e mirë	>130
E mirë	<100
Mesatare	80
E keqe	<50

2.6 Të ushqyerit pas periudhës së kulloshtirës

Pas kohës së kulloshtirës shumica e fermerëve pyesin se me çfarë qumështi duhet të vazhdohet gjatë javëve të ardhshme të jetës së viçit. Fermerët mund të zgjedhin në mes qumështit të plot apo zëvendësuesve të qumështit duke filluar prej ditës së tret apo të katërt. Kjo varet edhe nga kostoja e rritjes. Nëse qumështi i lopës ka çmim të mirë dhe çmimi i qumështit pluhur është më i lirë atëherë fermeri duhet të bëjë një llogaritje dhe të përcaktohet me cilin lloje të qumështit do të vazhdojë të ushqej viçat. Po ashtu kjo varet edhe nga kushtet që i posedon fermeri për përgatitjen e qumështit pluhur sa i përket higjienës dhe mënyrës së dhënies në temperaturën adekuate që kërkohet ta ketë qumështi.

2.7 Zëvendësuesit e qumështit (qumështi pluhur)

Viçat do të marrin të gjithë komponentë e nevojshme të qumështit nëse kualiteti i qumështit pluhur është i mirë. Zëvendësuesit e qumështit gjithmonë kanë komponentët e nevojshme kur është përgatitur në mënyrë të duhur. Po ashtu zëvendësuesit e qumështit janë të njohur që i kanë të balancuara lëndet ushqyese me përbërës të mjaftueshëm për rritjen e viçave. Transferimi i sëmundjeve nëpërmjet qumështit të lopës tek viçi është më i vogël me përdorimin e zëvendësuesve të qumështit. Zëvendësuesit e qumështit me proteina shtazore janë më të preferuar se me proteina me origjinë bimore, për shkak se viçat proteinat me origjinë shtazore i tretin më mirë.

Temperatura

Përgatitja e zëvendësuesve të qumështit duhet të bëhet në temperaturë 40°C. Dhe duhet ti jepet viçit në temperaturën e trupit (37°C).

2.8 Të ushqyerit me qumësht

Të ushqyerit me qumështin e lopës, viçit i siguron ushqimin që i plotëson kërkesat për të ushqyerit e viçave. Veçanërisht në ato raste kur fermeri ka problem të përgatit qumështin në mënyrën e duhur, për këtë arsye të ushqyerit me qumësht është opsioni më i mirë. Sidoqoftë përbërja e qumështit mund të ndryshoj; në disa raste mund të ketë sasi më të madhe të yndyrës, e cila mund të shkakton ndjenje të viçi se ka marr sasi të mjaftueshme të ushqimit. Kjo mund të dekurajoj viçat që ti marrin përbërësit tjerë si koncentrat apo silazh. Po ashtu viçat janë më të prirë të preken nga anemia kur ata ushqehen vetëm me qumësht, si shkak i mungesës së hekurit. Përqindja më e lartë e yndyrës në qumësht shkakton në shumë raste diarre për shkak se viçat e tretin më vështirësi yndyrën.



Vëmendje:

Nga dita e tretë e lindjes, viçi duhet të ketë në dispozicion koncentrat për viça me përqindje të lartë të proteinave 19 % dhe të jetë me shije të mirë në mënyrë që viçat ta konsumojnë sa më shpejt (duhet të kërkohet në treg koncentrat i cili prodhohet për viça).

Nga dita e 10, viçit duhet ti ofrohet edhe sanë e kualitetit të mirë.

Pse është e rëndësishme që viçat të ushqehen me koncentrat dhe sanë?

Koncentrati dhe sana e zhvillojnë rumenin e viçit. Nëse viçi ushqehet vetëm me qumësht në muajt e par atëherë rumeni i viçit nuk zhvillohet mirë dhe kur të ndahet viçi nga qumështi, rumeni i viçit nuk është i përgatitur për të tretur koncentratin dhe sanën dhe si pasojë kemi humbje të peshës së viçit në kohën kur i ndërpritet qumështi. Për këtë arsye gjithmonë viçi duhet të ketë në dispozicion koncentrat dhe sanë kualitative. Shih në foto zhvillimin e rumenit në 6 javët e para me ushqime të ndryshme.



2.9 Zhvillimi i rumenit të vëçit me qumësht, koncentrat dhe sanë

6 JAVË USHQIM ME QUMËSHT DHE SANË



6 JAVË USHQIM ME QUMËSHT DHE KONCENTRAT



6 JAVË USHQIM ME QUMËSHT, SANË DHE KONCENTRAT



Ky është zhvillimi optimal i rumenit të vëçit


2.10 Uji

Uji nuk duhet të nënvlerësohet, viçat duhet të kenë ujë të freskët gjatë periudhës së të ushqyerit me qumësht. Rezultatet e fundit tregojnë se nëse viçat kanë në dispozicion ujë të freskët, rritja është më e mirë. Viçat preferojnë ujë të vaket. Uji duhet të ju jepet prej ditës së shtatë dhe duhet ta kenë gjithmonë në dispozicion.



2.11 Ndarja nga gjiri

Preferohet që viçat të ndahen nga gjiri në mes ditëve 70 deri 80 (kjo varet edhe nga pesha trupore e viçit). Në shumicën e rasteve periudha me e gjatë e të ushqyerit me qumësht do të qojë në një trashje më të shpejt dhe marrje më të vogël të ushqimeve voluminoze dhe koncentratit. Kur të ushqyerit me qumësht apo zëvendësues të qumështit ndërpritet, viçat do të kenë mungesë të energjisë dhe proteinave të cilat duhet të zëvendësohen me ushqime voluminoze dhe koncentrat. Është shumë me rëndësi që kjo fazë të kalohet ngadalë. Ngadalë duhet të ulet sasia e qumështit dhe të rritet sasia e koncentratit për të arritur në maksimum 2 kg në ditë. Përqindja e proteinave të përgjithshme në koncentrat duhet të jetë 18-19% i cili duhet të përmbajë: grurë, elb, misër dhe melase të panxharsheqerit për të rritur shijen e ushqimit. Ky koncentrat do të stimulojë në zhvillimin e rumenit, i cili është shumë me rëndësi në pjesën tjetër të jetës për të konsumuar përbërësit tjerë të ushqimit. Gjatë kësaj periudhe është mirë që viçat të ushqehen me koncentrat starter, viçat mund të marrin më shumë lëndë ushqyese nga ky koncentrat se sa nga ushqimet voluminoze.



2.12 Pesha trupore

Vëmendje tjetër të veçantë para se të vendosim të ndahet viçi nga gjiri duhet ti kushtohet peshës së gjallë trupore të viçit. Kjo duhet të jetë në mes 12 deri 15 % e peshës së lopës së rritur. Pesha ideale e viçit të racës Hollshtain për ndarje nga gjiri është 80 kg. Përdoreni matjen e perimetrit të gjoksit e cila është një metodë shumë e mirë për të përcaktuar peshën e viçit. Në tabelën 1 janë të përshkruara gjerësia e perimetrit të gjoksit që korrespondon me peshën trupore të viçit.

Tabela 1. Rritja optimale e viçave

	Pesha e lopës se rritur në%	Pesha e gjallë e viçit (kg)	Perimetri i gjoksit të viçit (cm)	Lartësia (cm)	Shtimi i peshës ditore (gram)
Lindja	6	41	-	-	-
Ndarja nga gjiri	12	80	96	-	-
6 Muaj	26.5	180	129	108	700-800
12 Muaj	50	340	161	126	800-850
Inseminimi i par	55-60	375-400	168-174	130-133	675-725
18 Muaj	68	460	182	135	600-650
Pas pjelljes se par	85	580	197	145	-
Lopë e rritur	100	680	212	146	-

Llogaritja e peshës trupore për ndarjen e viçit nga gjiri:

Kur pesha mesatare e lopës është 650 kg, pesha ideale e ndarjes se viçit është rreth 78kg ($0.12 \times 650 = 78$ kg)

Kur pesha e gjallë e lopës është 700 kg, pesha ideale e viçit për ndarje duhet të jetë rreth 84 kg ($0.12 \times 700 = 84$ kg)

Lista kontrolluese për ndarjen e viçit nga gjiri

- A ka viçi në dispozicion ushqim të koncentruar të freskët dhe me shije të mirë?
- A ka viçi në dispozicion ujë të pastër?
- A është duke konsumuar viçi ushqime voluminoze?
- A është viçi 8 javësh?
- A peshon viçi rreth 80 kg peshë të gjallë?
- A është duke konsumuar viçi ushqim të koncentruar rreth 1-1.5 kg/ditë?
- A është viçi i shëndoshë?

KAPITULLI 3

3.1 Strehimi i viçave

Viçat e rinj duhet ti mbrojmë prej të gjitha ndikimeve negative që mund të kenë në shëndetin e tyre. Strehimi i viçave është një faktor tjetër shumë i rëndësishëm për të ju mundësuar viçave një rritje pa probleme. Varësisht nga mosha e viçave ata kërkojnë kushte të ndryshme të strehimit. Rekomandohet menjëherë pas pjelljes, viçat të strehohen në bokse individuale dhe pas 10 deri 12 ditë të mbahen në bokse grupore - në grupe. Në këto bokse të përbashkëta viçat duhet të mbahen një javë pasi të ndahen nga qumështi.

3.2 Mbjajta e viçave ndaras nga lopët

Për arsye se viçat janë me të ndjeshëm ndaj sëmundjeve rekomandohet që viçat të mbahen ndaras nga lopët, preferohet në stalla të ndryshme. Se paku 6 muajt e par të jetës së viçit rekomandohet që viçat mos të kenë kontakt me lopët. Viçat do të kenë me pak infeksione dhe mortaliteti do të jetë më i vogël.

3.3 Mbjajta e viçave në bokse individuale

Për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ndërmjet viçave, viçat duhet të mbahen në bokse individuale tre javët e para. Bokset individuale të viçave kanë edhe përparësi tjera pasi që me letë mund ti kontrollojmë në aspektin shëndetësor dhe rritjen e tyre.

Gjatë strehimit të viçave duhet të kemi kujdes që ventilimi të jetë optimal dhe mos ti ekspozohen erërave. Gjithmonë duhet të kemi kujdes që shtroja të jetë e terur dhe e pastër dhe boksi të pastrohet pas çdo largimit të viçit në bokse të përbashkëta. Nëse viçi paraprak ka pasur probleme shëndetësore, pa tjetër boksi duhet të dezinfektohet para se viçi i ri të vendoset aty.



3.4 Mbjajta e viçave në bokse të përbashkëta

Mënyra më e mirë për mbajtjen e viçave është mbajtja në grupe, preferohet në shtroj me kashtë. Shtoja e thellë me kashtë ka treguar rezultate më të mira dhe është shumë më efcientë në aspektin e fuqisë punëtore. Në këto bokse duhet vetëm një herë brenda ditës të ju shtrohet kashtë dhe se paku çdo tre muaj duhet të pastrohen në tërësi boksi. Preferohet që grupi i viçave në bokse të mbahet i njëjtë sa të jetë i mundur me qëllim për të zvogëluar stresin. Tri gjerat kryesore për strehimin e viçave janë: **drita, ajri dhe hapësira.**



3.5 Mbjajta e viçave për riprodhim

Fermerët mbajnë viçat e rinj për të zëvendësuar lopët të cilat i kanë në laktacion, lopët e vjetra do të zëvendësohen me viçat e rinj. Si shembull mesatarja e zëvendësimit të lopëve të vjetra në Holandë është rreth 30%. Kjo do të thotë që një fermë prej 100 lopëve, 30 lopë qumështore do të jenë në laktacionin e par (mëshjtjerra). Sidoqoftë gjatë rritjes së mëshjtjerrave kemi ndonjë dështim atëherë duhet të kemi me shumë se 30 viça të rinj për të prodhuar 30 mëshjtjerra. Në përgjithësi fermerët duhet të kenë se paku 25 % remontin e lopëve në fermat e tyre.



Kapitulli 4

4.1 Monitorimi i rritjes

Në momentin kur viçi ndahet nga ushqimi me qumësht, viç ka kaluar periudhën më të vështirë sa i përket sëmundjeve dhe mortalitetit. Të ushqyerit me qumësht ka kosto me të lart dhe tani duhet të fokusohemi që ti krijojmë kushte sa më të mira viçit për rritje. Duhet të monitorojmë procesin e rritjes së viçit para se të bëjmë inseminimin e par. Tek raca Holshtain qëllimi është që mështjerra të arrijë peshën trupore rreth 580 kg në pjelljen e par, ndërsa te raca Simental pesha trupore në pjelljen e par duhet të jetë rreth 625 kg.

4.2 Matja e peshës së gjalle të viçave/mështjerrave

Me matjen perimetrit të gjoksit mund të llogarisim peshën e viçit/mështjerrës. Matja e perimetrit të gjoksit duhet të bëhet dy herë në vit në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë se a është duke u zhvilluar viçi sipas standardeve që kërkohen. Në tabelën 2 mund të gjeni raportin në mes perimetrit të gjoksit dhe peshës tek raca Holshtain dhe te racat kombinuara (mish/qumësht). Matja e perimetrit të gjoksit bëhet menjëherë prapa shpatullave.



4.3 Matja e lartësisë

Po ashtu është me rëndësi të matet edhe lartësia e rritjes me qëllim që të përcjellim se mështjerra a është duke u zhvilluar mirë. Nëse lartësia e xhidavisë së mështjerrave është 130 – 133 cm, kjo tregon se pesha e mështjerrës është rreth 375 – 400 kg. Kjo është pesha kur mështjerra duhet të inseminohet. Lartësia e optimale e xhidavisë në kohën e pjelljes të mështjerrat është nga 142 deri në 146 cm.



Tabela 2 – Lidhja në mes perimetrit të gjoksit (cm) dhe peshës trupore (kg) në bazë të racave

Perimetri i gjoksit (cm)	Raca Holshtain	Racat e kombinuara
75	41	41
80	49	50
85	58	60
90	68	70
95	78	91
100	90	94
105	103	107
110	117	122
115	132	140
120	149	157
125	167	176
130	186	197
135	206	219
140	228	244
145	251	271
150	275	298
155	301	326
160	329	352
165	358	382
170	389	414
175	421	446
180	455	481
185	491	515
190	528	555
195	568	595
200	609	635
205	652	670

4.4 Inseminimi

Fermerët duhet të kenë kujdes në paraqitjen e afshit të mështjerrat, në përzgjedhjen e demit dhe çka është me rëndësishmja kohën optimale të inseminimit. Afshi të mështjerrat paraqitet për herë të par kur ato janë në moshën 10 deri 13 muaj. Në bazë të grafikonit të rritjes, koha optimale për inseminimin e par të mështjerrave është mosha 14 deri 15 muaj. Por sidoqoftë mosha nuk është faktor i vetëm që duhet pas në konsideratë për të inseminuar mështjerrën. Në moshën 14 deri 15 muaj, mështjerra duhet të ketë arrit peshën trupore 375 – 400 kg dhe



lartësinë se paku 133 cm. Në praktik shpesh kjo nuk ndodh për shumë faktorë. Mështjerrat mund të kenë pasur probleme me sëmundje, ushqimi mund të ketë qenë me kualitet të dobët apo strehimi nuk i ka plotësuar kushtet optimale.

Koha optimale për inseminimin e mështjerrave është moshë 14 deri 15 muaj. Në këtë moshë, mështjerra duhet të ketë peshën trupore 375 – 400 kg dhe lartësinë se paku 133 cm.

Mbajë mend, pesha dhe lartësia janë faktorët kryesor që duhet përcjellë për te inseminuar mështjerrën se sa moshë, sepse mështjerra duhet të zhvillohet mirë para se ajo të pjellë.

Lista kontrolluese për inseminimin e mështjerrave

- A është mështjerra ne moshën 14 – 15 muaj?
- A është mështjerra se paku 375 kg?
- A është perimetri i gjoksit te mështjerra ne mes 170 – 172 cm?
- A është lartësia e mështjerrës 133 cm?
- A është zhvilluar ne përgjithësi mire mështjerra